

VEPRIMTARIA SHKENCORE E SHABAN DEMIRAJT

Jup Kastrat
Shkodër

- Shkruar me rastin e 75-vjetorit të lindjes -

KUD 809.198.3-3
Punim studimor

Marrë për botim, më 26.II.1997

P ë r m b a j t j a e s h k u r t ë r: Në këtë punim, autori ka shqyrtuar veprimtarinë shkencore albanologjike të prof. Shaban Demirajt në fushën e leksikologjisë, fonetikës, morfologjisë, sintaksës, gramatikës historike, historisë së gjuhës shqipe, etimologjisë, gjuhës së shkruar shqipe, gjuhës letrare, ortografisë, ballkanistikës, marrëdhënieve gjuhësore shqiptaro - rumune, historisë së albanologjisë, etj.

1. Akademiku Shaban Demiraj i është afruar fushës së albanistikës, duke ardhur nga bota e publicistikës (1943-1944), e beletristikës, e literaturës reflektive artistike dhe duke vazhduar me shqipërime e redaktime. Gjurmimet e tij shkencore tregojnë një përzjerje të lumtur të gjuhëtarit dhe të letrarit. Ajo që e dallon veprimtarinë albanologjike të këtij dijetari të shquar të kohërave tona, është se, informacionit të gjerë e saktësisë shkencore, vjen e i shtohet edhe talenti i shkrimtarit.

Redaktimet, transkriptimet, përkthimet dhe përshtatjet e bëra prej tij dëshmojnë për interesat e gjera shkencore e të shumanshme të dijetarit tonë. Mjafton të përmendim shqipërimin aq të goditur të romanit *Maritn Iden* të Xhek Londonit (1959), redaktimet, pajisur me shënime të pasura gjuhësore, të veprave të Naim Frashërit: *Lulet e verësë* (1956), *Bagëti e bujqësija* (1956), si edhe të veprës së Sami Frashërit: *Shqipërija ç'ka qënë, ç'është dhe ç'do të bëhetë* (1962), në bashkëpunim me Zihni Reson dhe Kristo Frashërin. *Letërsia klasike* (greke e latine) (1953), botimi i dytë redaktuar në

bashkëpunim me prof. Mahir Domin, për shkollat e mesme, ka shërbyer, për vite me radhë, si tekst mësimor.

2. Një fushë dijeje, e cila e ka tërhequr që në fillim të veprimtarisë së tij kërkimore, ka qenë ajo e arbëreshëve të Italisë. Këtu hyjnë një varg botimesh me vlerë, si *Historia e gjuhës së shkruar të arbëreshëve të Italisë*, dispensë, botim i Ministrisë së Arsimit dhe të Kulturës (1956), shekujt XVI-XIX; ribotuar, më 1962 dhe 1967, nga Universiteti i Tiranës, Fakulteti Histori-filogji, Katedra e gjuhës shqipe (dispensë); ribotuar, si libër, në Kosovë nga Universiteti i Prishtinës (1970), nën redaktimin e Mr. Ahmet Këlmendit. Kjo vepër është përpjekja e parë në studimet tona. Pas një vështrimi të shkurtër mbi të folmet e arbëreshëve të Italisë, autori flet për lëvrimin e gjuhës amëtare në ngulimet arbëreshe për grafinë, ortografinë, leksikun, format gramatikore dhe konstruktet sintaktike në shkrimet e arbëreshëve të Italisë.

Në studimin *Disa shënime të krahasuara mbi gjuhën e Varibobës* (1953), Demiraj shqyrton fonetikën, morfologjinë, leksikun dhe bën vërejtje rreth disa elementeve, ku gjuha e Varibobës përpjek me të folmet e gegërishtes. Punimi *Gjella e Shën Mërisë Virgjër e Jul Varibobës* (1956) merret me botimin e parë të kësaj poeme (1762) dhe me transkriptimin e bërë nga prof. Vinçenc Librandi si edhe me kritikën shkencore përkatëse. *Dyqindvjetori i botimit të veprës së parë letrare artistike të shqipes, "Gjella e Shën Mërisë Virgjër" të Jul Varibobës* (1962) është një studim me vlerë. *Kënga e sprasme e Balës* poemë e Gavrill Darës të Riut, përshtatur në gjuhën e sotme shqipe dhe pajisur me shënime nga Shaban Demiraj (1961), iu paraqit lexuesve me qëllim që të kuptohet më lehtë prej tyre. Përshtatja, në përgjithësi, i qëndron besnike origjinalit. Por, për të mos prishur bukurinë e veprës, Demiraj e ka parë të arsyeshme që të mos bënte një "kthim" të thatë në shqipen e sotme. Prandaj, pa i ndryshuar aspak mendimet e Poetit, aty-këtu ka bërë edhe ndonjë ndryshim të vogël në fjalë e konstrukte. Për ta paraqitur veprën me bukurinë dhe madhështinë e saj, është përpjekur që edhe në këtë përshtatje të ruajë stilin konciz të autorit.

Pas më shumë se tridhjetë vjetësh, më 1994, Shaban Demiraj iu kthye edhe një herë poemës së bukur, *Kënga e sprasme e Balës* të Gavrill Dara të Riut. Iu përvesh prapë punës për të përmirësuar më tej përshtatjen e mëparshme të botuar të kësaj kryevepre, si edhe transkriptimin e origjinalit të saj, që i kishte mbetur dorëshkrim Demirajt. Kështu lexuesi ka mundësi t'i shijojë edhe më mirë bukurinë e rralla të kësaj perle të letërsisë sonë artistike dhe të mësojë edhe mendimet e këtij shkrimtari të Letërsisë arbëreshe të shprehura në Parathënien dhe pasthënien e veprës së tij. Kështu, pra, poema u përgatit në një botim të tretë, u transkriptua dhe u përshtat në shqipen e sotme, duke u shoqëruar edicioni i ri me parathënie të shkurtër, me një hyrje studimore. Në të janë shqyrtuar kushtet historike dhe veprimtaria e Gavrill

Darës të Riut, analiza e veprës: Brendia, vetat vepruese (personazhet), veçoritë e poemës, një fjalorth në rend alfabetik me 540 fjalë të së folmes arbëreshe të shpjeguara. Vepra u recenzua nga Ali Xhiku dhe Klara Kodra. Redaktore: Rozeta Uçi. Tirazhi: 2000 kopje.

Një artikull me vlerë i Demirajt është edhe: *Gabriele Dara il Giovane*, të revista *Albania Nuova* (1965). Në fushën e studimeve të arbëreshëve të Italisë është edhe diskutimi i Demirajt për kumtesën e Eqrem Çabejt, *Ngulimet shqiptare në Itali dhe Gjuha e tyre* (1959).

3. Me raste jubilesh, edhe historia e alfabetit të gjuhës shqipe ka hyrë në sferën e interesave të dijetarit tonë. Le të përmendim këtu disa ndihmesa të vyera të tij: *Përpyjekjet për vendosjen e një alfabeti të vetëm për shkrimin e gjuhës shqipe* (1961), *Alfabetarja e gjuhës shqipe* (Me rastin e 100 vjetori të botimit, 1979), *Ngjarja e shënuar në historinë e kulturës sonë kombëtare* (Me rastin e 70-vjetorit të Kongresit të Dytë të Manastirit, 1980), *Kongresi i Manastirit-ngjarje e rëndësishme në historinë e popullit tonë* (14-22 nëntor 1908) (1968). Por në këtë lëmë kërkimesh meriton të theksohet në veçanti broshura e titulluar: *Kongresi i Manastirit-ngjarje me rëndësi në lëvizjen kombëtare shqiptare*. Ky punim, i hartuar në bashkëpunim me Kristaq Priftin, pati dy botime: më 1968 dhe 1978. Në të, në fillim, bëhet një historik i shkurtër i shkrimit të shqipes. Pastaj flitet për lëvizjen politiko-kulturore në Shqipëri pas Revolucionit të Turqve të rinj, për zhvillimin e Kongresit të Manastirit, për luftën e popullit shqiptar kundër reaksionit xhonturk për shkrimin dhe shkollën shqipe pas Kongresit të Manastirit (1908-1910).

4. Edhe problemet e ortografisë dhe të gjuhës letrare janë trajtuar disa herë në shkrimet e Shaban Demiraj. Le të kujtojmë këtu: *Një kontribut me vlerë për kristalizimin e gjuhës letrare* (Diskutim rreth "Rregullave të drejtshkrimit të shqipes", (1967), *Kongresi i Drejtshkrimit dhe kristalizimit i mëtejshëm i shqipes letrare kombëtare* (1972), *Rreth disa çështjeve gramatikore në "Rregullat e drejtshkrimit të shqipes"* (1972), *Prirjet kryesore në strukturën morfologjike të gjuhës së sotme letrare shqipe* (1988), etj.

5. Historia e gjuhës së shkruar shqipe është një fushë, në të ciln Shaban Demiraj ka dhënë ndihmesa të vyera, me gjurmimet dhe studimet e tij shumëvjeçare. Ato fillojnë me studimin: *Gjuha e Sami Frashërit* (leksiku, derivatet, vërejtje rreth parashtesave, mbiemrat e substantivuar, kompozitat) (1955). Vazhdojnë me: *Historia e gjuhës së shkruar shqipe*. Shekujtë XVIII-XIX. Dispensë. Botim i Ministrisë së Arsimit dhe të Kulturës (1956). *Lëvrimi i gjuhës shqipe gjatë shekullit XIX*. Dispensë. Universiteti i Tiranës (1962, 1968). Ribotuar në Kosovë, nga Univeristeti i Prishtinës (1970).

Në këtë studim autori ka shqyrtuar fjalorin, ortografinë, përpjekjet për të sfruar të dy dialektet e shqipes në të shkruar, disa vërejtje rreth formavet,

konstruktet sintaktike duke nxjerrë edhe përfundimet përkatëse. Të dhëna të shumta konkrete ka nga Konstandin Kristoforidhi, Pashko Vasa, Naim Frashëri, Sami Frashëri, Ndre Mjeda, Jani Vretoja, Engjëll Radoja, Ndrekë Logoreci, Ndoc Nikaj, Pashkë Babi etj. Përpara se të përfshihej në dispense, Demiraj e pat botuar, si studim më vete, më 1958 dhe 1959, nën titullin: *Disa shënime rreth lëvrimin të gjuhës shqipe gjatë shekullit XIX*. Punimi jep dorë për t'u vazhduar më tutje me një vështrim më të gjerë. Në lëmin e gjuhës së shkruar shqipe, janë për t'u përmendur edhe tri studime të tjera plot interes shkencor: *A ka pasur një traditë shkrimi të gjuhës shqipe para Buzukut?* (1995), *Rëndësia e veprës së Buzukut për studimet historike të gjuhës shqipe* (1995), *Ndihmesa e Sami Frashërit në lëvrimin e gjuhës shqipe* (1979), *Fan.S.Noli dhe gjuha e tij* (1982). Në këtë fushë dijeje mund të përfshihen edhe artikujt: "Meshari" i Gjon Buzukut (1962), *Shkrimtarët e vjetër të Veriut* (1962), *Dëshmi e qëndresës* (Pjetër Bogdani, 1984), *Rilindasit dhe gjuha e tyre* (1962), etj.

6. Leksikologjia dhe fonetika kanë qenë dy disiplina gjuhësore të Demirajt, të cilat e kanë interesuar që në fillimet e veta të veprimtarisë së tij diturake. Në këtë vështrim, vijnë në konsideratë veprat *Leksikologjia dhe fonetika e gjuhës shqipe*, konspekt-leksione, dispense (1956), botim i Ministrisë së Arsimit dhe të Kulturës; *Materiale ndihmëse për fonetikën shqipe*, dispense, botim i Univeritetit të Tiranës (1958). Në fushën e fonetikës historike duhen theksuar këtu studimet: *Rreth diftongimit të O-së në gjuhën shqipe* (1981), *Theksi në gjuhën shqipe* (Vështrim historik) (1984), *Rreth apofonisë në gjuhën shqipe* (1986). Punimet e fundit karakterizohen për fuqi analize dhe sinteze.

7. Edhe terminologjia, leksikografia dhe sintaksa janë prekur, sado në mënyrë anësore, nga Shaban Demiraj. Le të kujtojmë këtu: *Fjalor i termave të gjuhësisë* (bashkautor, 1975), *Aleksandër Xhuvani për pastërtinë dhe pasurimin e gjuhës shqipe* (1980), *Fjalor i gjuhës së sotme shqipe* (recension, 1980), *Rreth rimarrjes së kundrinave në gjuhët ballkanike* (1983), *Rreth rimarrjes së kundrinave në gjuhën shqipe* (1983). Dy studimet e fundit shquhen për interpretime të sakta, për përgjithësime dhe konkluzione bindëse.

8. Diskutimet e zhvilluara rreth kumtesave të Eric P. Hamp-it, Wilfred Fiedler-it, Oda Buccholz-it, Gunnaar Svane-s, Vitore Pisani-t, Eqrem Çabejt, Androkli Kostallarit, Bahri Becit, Joland Mindakut, Victor Friedman-it, Istvan Schutz-it, Robert Elsie-s etj. në kuvendet studimore, brenda dhe jashtë Shqipërisë; kumtesat e lexuara ndër konferencat albanologjike e ballkanologjike dhe kongreset kombëtare e ndërkombëtare si edhe ligjëratat e mbajtura në Prishtinë, Shkup, Sofje, Athinë, Boegrad, Kluzh, Kopenhagë, Aarhus, Insbruk, Vjenë, Romë, Paris, Këln, Salerno, Nju Jork etj.; kurset sistematike

të leksioneve për shqipen në Institutin e Lartë Pedagogjik dhe në Univeristetin e Tiranës; mësimet e dhëna për gjuhën shqipe në gjimnazin e Gjirokastrës (1948), në Politeknikumin "7 Nëntori" dhe në Shkollën Pedagogjike të kryeqytetit; qenia e tij pedagog (1954), shëf i Katedrës së gjuhës shqipe dhe zv/dekan i Fakultetit Histori-Filologji (1962-1989); pjesëmarrja e tij në diskutimin e monografive gjuhësore në Sektorin e gramatikës Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë; oponencat për disertacionet e mbrojtura, konsulencat dhe udhëheqja e tij të temave të diplomave universitare dhe të titujve e gradave shkencore të aspiranturës, docenturës, doktoranturës, profesoranturës të punonjësve të ndryshëm pedagogjikë e shkencorë; anëtarësia e tij në redaksitë e revistave *Studime filologjike* dhe *Gjuha jonë* si dhe në dy vëllime *Seminari XVII dhe XVIII Ndërkombëtar për gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare* (1995,1996); hartimi i teksteve mësimore dhe i manualëve të shqipes për shkollat e mesme dhe të larta; studimet shkencore, monografite, artikujt shkencorë dhe divulgativë, referatet, kumtesat, referimet, botimet e posaçme diturake, artikujt publicistikë, redaktimet, transkriptimet, përshtatjet, përkthimet; anëtarësia e tij në grupet e punës për përpilimin e disa veprave me rëndësi të gjuhësisë shqiptare, - të gjitha këto, dhe të tjera si këto, dëshmojnë për punën e madhe të Akademikut Shaban Demiraj për lëvrimin dhe studimin e gjuhës sonë.

Ato pasqyrojnë dukuritë e ndryshme të këtij dijetari të shquar, erudicionin e këtij gjuhëtarit të përmendur të kohërave tona, punën këmbëngulëse dhe sistematike të tij, pasionin me të cilin i është vënë lëvrimin të gjuhës amëtare që prej pesëdhjetë vjetësh, si mësimdhënës, si autor tekstesh dhe si studiues i zellshëm. Me punën e tij shumë frytdhënëse, si është bërë një shembull i mirë për t'u ndjekur nga punonjësit e rinj shkencorë të gjuhësisë bashkëkohore shqiptare. Prof.Demiraj është një personalitet poliedrik me renome evropiane, një autoritet shkencor dhe një nga figurat më eminente, më markante të studimeve albanologjike të gjysmës së dytë të shekullit tonë, brenda dhe jashtë Shqipërisë.

9. Me këtë bagazh të madh njohurish, me këtë horizont dhe diapazon të gjerë gjuhësor si edhe me njohjen, nga ana e tij, të disa gjuhëve të huaja, të vdekura dhe të gjalla, klasike dhe moderne, lindore dhe perëndimore, Akademiku Shaban Demiraj ka kohë që është bërë autoritet shkencor i morfologjisë së gjuhës shqipe dhe i gramatikës historike. U mbushën tridhjet e pesë vjet që ai po mirret me problemet e morfologjisë së gjuhës së sotme shqipe. Mjafton të shënojmë këtu tekstin *Morfologjia e gjuhës së sotme shqipe*, dy dispensa, botim i Universitetit të Tiranës, Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë, Katedra e gjuhës shqipe (Botimi I, 1961). Ka punuar gjashtë ribotime e rishtypje. Është ribotuar, si libër, nga Universiteti i Prishtinës (1971). *Gramatika e gjuhës shqipe* pjesa e parë (Fonetika dhe Morfologjia),

tekst për shkollat pedagogjike (1962). *Gramatika e gjuhës shqipe* për shkollën e mesme pedagogjike (1962). *Gramatika e gjuhës shqipe* për shkollën e mesme pedagogjike, tekst i ri., punuar së bashku me Nikoleta Cikulin (1971). *Libri i gjuhës shqipe*.

1. Maket Për shkollat e mesme pedagogjike dhe të huaja. Autorë: Shaban Demiraj, Ali Jashari, Virgjini Lafe, Liljana Harito (1984).

Veprave madhore dhe kryeveprave të Akademikut Shaban Demiraj, gjatë tridhjetë viteve të fundit, u kanë paraprirë një varg studimesh dhe monografish, në plan sinkronik dhe diakronik, për morfologjinë dhe gramatikën e shqipes. Këtë ndihmesë të çmueshme të dijetarit tonë të shquar e ilustronjë më së miri, në formë panoramike, titujt e këtyre studimeve speciale: *Forma gramatikore perifrastike për emër foljor i gjinisë asnjënese në trajtë të pashquar* (1965); *Rreth ndërtimit të gjinisë së emrave në shumës, vështruar dhe në përqasje me rumanishten* (1966); *Rreth mbaresavet të shumës të emrave asnjënës në gjuhën shqipe* (1968); *Rreth disa problemeve të paskajores në gjuhën shqipe, punim historik* (1969); *Emrat prejfoljorë asnjënës dhe togjet me vlerë foljore të formuara me pjesëmarrjen e tyre* (punim historik, 1969); *Rreth klasifikimit të foljeve në zgjedhime* (1969); *Rreth kategorisë së shquarësisë e të pashquarësinë në gjuhën shqipe* (1969); *Rreth ndajfoljësimit (adverbializmit) të disa formave gramatikore dhe të disa togjeve të tipit parafjalë+emër* (1970); *Rreth formavet të së ardhmes në gjuhën shqipe* (1970); *Rreth zhdukjes së paskajores në gjuhën shqipe* (1970) *Habitorja dhe mosha e saj*, punim historik (1971); *Disa vërejtje rreth foljeve jam, kam dhe thom dhe rreth alternimit -e/-ie: -i- në sistemin foljor të shqipes*, punim historik (1972); *Kuptimet kryesore të kohëve të mënyrë dëftore në gjuhën shqipe* (1971); *Rreth risivet kryesore në sistemin e rasavet të gjuhës shqipe* (1973); *Rreth shumës: veçoritë e lakimit në sistemin për emër të emerit kalë në gjuhën shqipe; vështruar historikisht* (1973); *Çintegrimi i gjinisë asnjënese* (1973); *Rreth disa çështjeve themelore të morfologjisë historike të shqipes* (1974); *Rreth kategorive gramatikore të mënyrës dhe të kohës në gjuhën shqipe* (1977); *Rreth "nyjeve të mëparme" të shqipes, vështruar edhe në përqasje me rumanishten* (1978); *Rreth vendit të përcaktorëve në gjuhën shqipe* (1981); *A ka ndikime të huaja në strukturën morfologjike të shqipes?* (1981); *Rreth së ashtuquajturës kategori e masës në gjuhën shqipe* (1982); *Koha e formimit të gjuhës shqipe në dritën e disa të dhënave të struktues së saj gramatikore* (1982); *Vendi i formave të patheksuara të për emrave vetorë në shqipe dhe në disa gjuhë tjera* (1983); *singularizmi i shumës të emrave në gjuhën shqipe* (1985); *Prirjet kryesore në strukturën morfologjike të shqipes së sotme* (1985).

Gjashtë nga këto punime, janë përfshirë edhe në vëllimin *Studime rreth historisë së gjuhës shqipe*. Universiteti i Tiranës, fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë. Katedra e gjuhës shqipe (1973).

10. Në vëllimin *Çështje të sistemit emëror të gjuhës shqipe*, botuar nga Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë, katedra e gjuhës shqipe (1972), me 296 faqe, Shaban Demiraj ka përmbledhur tre studime, kushtuar disa çështjeve të rëndësishme të sistemit emëror të shqipes, në planin sinkronik e diakronik, ndër të cilat dy janë kontribute dhe një është monografi e plotë. Vepra u recenzua nga Mahir Domi, Fatmir Agalliu dhe Emil Lafe në Katedrën e gjuhës shqipe të Fakultetit të Historisë e të Filologjisë të Universitetit të Tiranës. Në shtypin shkencor u botuan dy recensione, në shqip dhe në gjuhë të huaja; i pari, nga Kolec Topalli, ndërsa i dyti nga Todor Bojan.

Çështjet e trajtuara në këto tre punime kanë interes shkencor. Ato janë trajtuar me seriozitet e kompetencë. Studimi i tyre shpihet përpara. Monografia *Asnjanësi në gjuhën shqipe* botohet për herë të parë nga autori. Është një studim tërësor dhe përgjithësisht i plotë i kategorisë së asnjanësit në gjuhën shqipe dhe i mjaft çështjeve të lidhura me të, shtjelluar në një plan të gjerë, si diakronik ashtu edhe sinkronik. Asnjanësi i shqipes është vendosur në kuadrin indoevropian, edhe në atë të gjuhësisë së përgjithshme është vështruar si në planin krahasues edhe në atë të historisë së brendshme. Vëmendje e veçantë i është kushtuar ndjekjes së historisë së kësaj kategorie gramatikore në gjuhën shqipe. Përveç kapjes së gjerë të temës, bie në sy edhe përpjekja për t'u shkuar gjer në fund çështjeve, për t'i rrëmuar ato nga çdo anë, e për të mos lënë gjëra të pasqaruar, qofshin ato edhe hollësi.

Monografia karakterizohet nga serioziteti dhe skrupoloziteti. Autori ka bërë një punë të madhe shumëvjeçare për studimin e letërsisë përkatëse indoevropëistike dhe albanologjike, për ndjekjen e kësaj kategorie në tekstet shqipe të vjetra e në letërsinë e kohës së re, për përpunimin dhe interpretimin e fakteve. Punimi është shumë i pasur në çështje, vëzhgime, mendime e materiale, dhe i një niveli të mirë shkencor. Është i shkruar mirë, parashtrimi është i qartë dhe zakonisht i saktë. Për çështjet e ndryshme janë dhënë jo vetëm një pasqyrë përgjithësisht e plotë dhe kritike e trajtimeve të mëparshme, por mjaft herë edhe mendime vetiake të reja.

Monografia mbështetet në një bibliografi shumë të pasur (afër 190 punime) me vepra të gjuhësisë indoevropiane të albanistikës, me gramatika të shqipes e përshkrime dialektore, e me studime për gjuhën rumune etj. E pasur është edhe lista e veprave të vjela (rreth 65). Autori, për një seri rastesh, ka parë edhe faktet analoge në gjuhët rumune, bullgare, serbokroate, neogreke, çka i ka lejuar t'i vendosë disa fakte të shqipes në një plan ballkanik që ndihmon për t'i bërë ato më të kuptueshme. Ai është shqiptuar, më se një herë,

edhe për çështje të gramatikës rumune. Ka mendime të drejta lidhur me burimin e gjenezën e disa konkordancave ballkanike. Të gjitha këto bëjnë që të arrihen mjaft rezultate me rëndësi, të sqarohen ose të sillen elemente për sqarimin e mjaft çështjeve të lidhura me kategorinë e asnjansit në gjuhën shqipe e t'u jepet një kontribut serioz e me shumë interes studimeve gramatikore të shqipes, gramatikës historike, edhe të sotmes të saj. (M.Domi)

Profesori Shaban Demiraj i Universitetit Shtetëror të Tiranës-shkruan Todor Bojan-na është i njohur nëpërmjet vëllimeve të mëparshme nga fusha e gramatikës, nëpërmjet studimeve të tij për gjuhën letrare shqipe, dialektologjinë, indoevropianistikën etj. Edhe vëllimi *Çështje të sistemit emëror të gjuhës shqipe* pasqyron gjithashtu preokupimet e shumanshme të autorit. Të tri studimet e përfshira në këtë vëllim, nëpërmjet tematikës së trajtuar, janë në përputhje me titullin e përgjithshëm të veprës. Dy studimet e para janë rimarrje, me plotësime të rëndësishme, të studimeve të botuara më parë. Studimi i tretë, që është më i gjeri, një monografi mbi gjininë asnjansë, botohet për herë të parë. Secili studim ka një përmbledhje të shkurtër në gjuhën frëngjishte. Vëllimi përfshin një bibliografi të gjerë, me mbi 200 vepra nga më përfaqësueset e indoevropianistikës, të albanologjisë, të gjuhësisë së përgjithshme, të gramatikave të gjuhëve latine, neogrek, franceze, italiane, rumune, etj. Ky vëllim është një studim thellimi për albanologët romanistët, sllavistët, indoevropianistët dhe specialistët e gjuhësisë së përgjithshme.

Monografia *Gjinia asnjansë në gjuhën shqipe* përfaqëson një model të mirë hulumtimi diakronik dhe sinkronik, horizontal dhe vertikal, të një problemi të gjerë dhe të vështirë, të diskutuar gjallërisht dhe gjatë. Nëpërmjet tematikës së trajtuar, nëpërmjet pasurisë së materialit gjuhësor të paraqitur dhe sistemit dhe sintezës së tij të drejtë, nëpërmjet analizave të thella dhe konkluzioneve të drejta, të nxjerra lidhur me problemet më të rëndësishme dhe më të vështira, që janë hulumtuar, ky vëllim përbën një kontribut të vlefshëm për njohjen e struktues gramatikore të njërës prej gjuhëve më të vjetra të Evropës dhe për njohjen e disa veçorive specifike të gjuhës shqipe.

Jemi të mendimit se për problemet që ka marrë në shqyrtim autori ia ka arritur ta thotë fjalën e tij, duke ndriçuar kështu tri çështje të rëndësishme të sistemit emëror të gjuhës shqipe. Në arritjen e konkluzioneve shkencore, mendojmë se faktorët përcaktues kanë qenë gjerësia e materialit me të cilin është punuar si dhe analiza e thelluar e këtij materiali dhe e studimeve të bëra në këtë fushë. Shtojmë se gjatë analizës së problemeve të marra në shqyrtim, herë pas here bëhen edhe vërejtje teorike që kanë interes edhe për ballkanistikën. Si përfundim, mendojmë se *Çështje të sistemit emëror të gjuhës shqipe* jep një kontribut të çmueshëm për sqarimin e një seri problemesh të morfologjisë së sotme dhe historike të shqipes; në të njëjtën kohë këto studime, së bashku me disa të tjera lidhur me sistemin foljor ..., për

vetë autorin, shënojmë një hop cilësor në studimin e thelluar historik të gjuhës sonë, duke hedhur një hap të mirë përpara në gjuhësinë krahasimtare. Botimi i libri *Çështje të sistemit emror të gjuhës shqipe* është për t'u vlerësuar si një iniciativë shumë pozitive që do t'i vlejë njohjes së studimeve albanologjike prej një rrethi më të gjerë lexuesish, si dhe rritjes të studiuesve të pasionuar të gjuhës sonë amëtare. (K. Topalli)

11. Vepra *Morfologjia historike e gjuhës shqipe* (pjesa I, 1973; pjesa II, 1976) është një vepër dinjitoze e gjuhësisë shqiptare. Është si një sintezë e një pjese të mirë të studimeve sipërshënuara të autorit tonë të nderuar, deri përpara njëzet vjetësh. Në katedrën e gjuhës shqipe të Fakultetit të Historisë dhe të Filologjisë të Universitetit të Tiranës, këto dy vëllime u recenzuan nga Mahir Domi, Jup Kastrati, Fatmir Agallin, ndërsa në shtypin shkencor u botuan recensione nga Jup Kastrati, Safet Hoxha, Fadil Sulejmani, Haralambie Mihaescu, Armin Hetzer.

Autori i kësaj vepre-thekson gjuhëtari rumun Haralambie Mihaescu- i ka vënë vetit si qëllim të grumbullojë, të sistematizojë dhe të diskutojë, në mënyrë të krahasuar, rezultatet e sigurta nga fusha e morfologjisë historike, për të hartuar, për studentët dhe specialistët, një manual, që ka për objekt evolucionin e strukturës së gjuhës shqipe. Është një fakt, përgjithësisht i njohur, që morfologjia mbetet pjesa më konservuese dhe më autentike e një gjuhe: ajo përbën skeletin e saj, që përshkohet me vështirësi nga ndikimet e huaja. Si rrjedhim, tiparet e saj specifike, të studiuara në planin sinkronik, janë në gjendje t'i japin hov hulumtimit tipologjik. Të vështruara nga pikëpamja diakronike, ato ndriçojnë evolucionin e gjuhës në shqyrtim. Por, kur është fjala për të studiuar gjuhën shqipe, do pasur parasysh se kemi të bëjmë me një situatë të veçantë.

Në të vërtetë, metoda krahasimtare, e zbatuar në atë gjuhë, nuk do të gjejë shumë pika mbështetjeje. Historiani i gjuhës rumune, si pikënisje të studimit, mund të marrë latinishten, që është e dokumentuar bollshëm. Ai shfrytëzon paralelizmat, që japin gjuhët rumune. Mund t'u referohet dialekteve (dakorumune, aromune, meglenorumune istrorumune). Nxjerr mjaft informata të dobishme nga tekstet sllave të shekujve X-XV. Mund t'u drejtohet gjuhëve ballkanike dhe, në fund të fundit, ka në dispozicion një literaturë të pasur për periudhën e shekujve XVI-XX.

Përkundrazi, albanologu duhet të kënaqet vetëm me të dhënat e studimit të krahasur të gjuhëve indoevropiane dhe me të dhënat e të folmeve që përdoren në klonitë shqiptare të Greqisë e të Italisë, të cilave u shtohen ato të një literaturë relativisht homogjene dhe jo aq të diferencuar të shekujve XVI-XX. Për këtë arsye, ne duhet t'i vështrojmë me simpati përpjekjet e bëra deri më sot nga specialistët për të krijuar një shkencë të tillë si albanologjia, e cila është e dobishme si për gjuhësinë e përgjithshme ashtu edhe për studimin e

gjuhëve fqinje. Këto përpjekje kanë nisur në fushën e komperativistve (F. Bopp, J.G. von Hahn, G. Meyer, H. Pedersen, K. Brugmann, N. Jokl, V. Pisani). Ato kanë gjetur një mbështetje të fortë tek ballkanistët (H. Baric, F. Miklosich, Kr. Sandfeld, P. Skok). Një ndihmë të rëndësishme u ka dhënë atyre krahasimi me rumunishten (B.P. Hasdeu, A. Philippide, O. Densusianu, T. Papahagi, A. Rosetti, A. Graur, G. Bricus) dhe në zhvillimin e tyre kanë ndihmuar shumë albanologët e vendeve të ndryshme (A.V. Desnickaja, M. Durante, M.A. Gabinskij, Kl. Haebler, E. Hamp, A.M. Seliscev, C. Tagliavini, G. Veigand). Por, natyrisht, specialistët më të mirë të kësaj fushe janë rekrutuar nga radhët e shqiptarëve të vendit ose të mërgimit (I. Ajeti, M. Camaj, D. Camarda, K. Cipo, E. Çabej, Sh. Demiraj, G. De Rada, M. Domi, A. Kostallari, M. La Piana, Gj. Pekmezi, A. Xhuvani, etj.).

Në studimin e formave dhe të varianteve të ndryshme autori nisat nga gjendja aktuale e gjërave duke bërë përpjekje për rindërtimin e të shkuarës, pasi i ka vendosur mirë ato në hapësirën gjeografike përkatëse. Përveç gjuhës së sotme shqipe dhe literaturës së shkruar, ai shfrytëzon me dobi të dhënat e dialektologjisë e të onomastikës, të cilave u shton të dhënat e studimeve ballkanike, gjithë duke mbajtur parasysh ndikimet historike dhe e përfundon hulumtimin e tij duke bërë lidhjen me fondin e lashtë indoevropian. Autori i vë vetes si qëllim të vazhdojë analizën e fakteve duke vendosur një kronologji relative dhe duke bërë dallimin midis formave më të vjetra dhe formave të evoluara ose analogjike, që u detyrohen shkaqeve të brendshme ose të jashtme. Ai vazhdon me shqyrtimin kritik të pikëpamjeve të shprehura deri më sot dhe propozon zgjidhje më të përshtatshme, që mbajnë parasysh lidhjet reciproke brenda sistemit të gjuhës shqipe si dhe evolucionin e tij, pa e ekzagjeruar rëndësinë e ndikimeve të huaja, por edhe pa i mohuar fare ato.

Përgjithësisht, ashtu si në latinishte, rumanishte dhe në gjuhë të tjera, sistemi morfologjik i gjuhës shqipe ka evoluar në drejtimin e një thjeshtimi progresiv. Format statistike ua kanë lëshuar vendin formave sintetike-analitike. Roli i parafjalëve, për të shprehur raportet rasore, është bërë më i rëndësishëm. Në klasën e emrave ky proces thjeshtimi ka njohur një ritëm më të shpejtë, kurse më të ngadalshëm në klasën e foljeve. Duke paraqitur, në mënyrë kritike, rezultatet e arritura deri më sot nga albanologjia, ky libër i prof. Demirajt ka meritën të jetë i informuar mirë, prudent në konkluzionet e pjeshme dhe shumë personal në gjykimet e përgjithshme. Ai ia arrin të japë përshtypjen se ndodhet në një terren solid dhe nuk mund veçse të çmohet lart nga kjo përpjekje informacioni.

Vepra është një trajtesë serioze, e një niveli të ngritur shkencor, që sjell kontribute të reja në studimin e morfologjisë historike të shqipes. Mahir Domi vëren se autori ka gjurmuar dhe ka arritur të njihet drejtpërsëdrejti me shumicën dërmuese të literaturës përkatëse dhe të mendimeve të shprehura,

andej e këndeje, për çështje të ndryshme të morfologjisë historike të gjuhës shqipe. Ai ka konsultuar edhe një numër veprash themelore të gjuhësisë indoevropiane e të gjuhësisë ballkanike. Ka parë edhe rezultatet e studimeve dialektore shqiptare e përshkrimet e të folmeve tona, po ashtu edhe gramatikat e gjuhëve të tjera ballkanike. Literatura e konsultuar është e gjerë, çka i ka lejuar të njihet mirë me çështjet e trajtuara, me gjendjen e studimit të tyre, t'i vendosë ato, herë-herë, në një kuadër më të gjerë dhe të jetë në gjendje të orientohet më mirë në zgjidhjen e tyre. Autori ka dhënë, zakonisht, për çështjet e ndryshme, edhe historinë e trajtimit të tyre, gjendjen e studimit të tyre, mendimet e ndryshme që janë shprehur. Informacioni i dhënë për historinë e trajtimit të çështjeve del mjaft instruktiv dhe i vlefshëm. Letërsia shkencore e mëparshme është parë me sy kritik, duke u vënë në dukje anët e dobëta të tezave e të pikëpamjeve të ndryshme. duke u marrë e duke mbajtur qëndrim ndaj tyre dhe duke u ndequr dobësi e të meta të tyre.

Autori, jo vetëm që përcakton qëndrimin e tij ndaj tezave e pikëpamjeve të ndryshme ekzistuese, duke e argumentuar atë, herë-herë, edhe me argumente e të dhëna të reja, kur pëqafon ndonjerën prej tyre, por, në mjaft çështje, sjell kontribute për zgjidhje të reja, shtron edhe çështje të pavëna në dukje më parë e të patrajtuara. Kontributi vetjak është i dukshëm e pozitiv. Janë studiuar me kujdes veprat e autorëve të vjetër dhe të të folmeve të disporës, me interes të veçantë, për historinë e gjuhës shqipe, janë nxjerrë prej tyre të dhëna të përpikëta me vlerë për sqarimin e historisë së brendshme të shqipes. Mendimet e autorit janë të matura, të formuluar mirë e në një gjuhë të sigurtë, zakonisht në mënyrë koncize. Trajtesa dëshmon për pjekuri shkencore.

Në këtë mënyrë, me këtë gamë të gjerë rrahjeje problemesh të ndryshme, *Morfologjia historike e gjuhës shqipe*, pjesa e parë dhe e dytë, hartuara nga Shaban Demiraj, bëhet vepra e parë e plotë mbi këtë disiplinë gjuhësore. Me referimet e pasura bibliografike, me burimet e shumta dhe të ndryshme, teksti në fjalë do të jetë një shtytje e mirë për studime të mëtejshme në gramatikën historike të shqipes. Fatmir Agaliu ka theksuar, me të drejtë, se njohja dhe shfrytëzimi i mirë i literaturës albanologjike, njohja e disa veprave të gjuhësisë krahasuese indoevropiane, shfrytëzimi i të dhënave të gjuhës së autorëve të vjetër dhe të dialekteve si edhe përgatitja linguistike e shëndoshë i kanë dhënë mundësi autorit, jo vetëm të sintetizojë arritjet e derisotshme dhe të mbështesë më tej tezat, përgjithësisht, të pranueshme, por edhe të japë një radhë kontributesh vetjake.

Me disa nga problemet e parashtruara në këtë tekst, autori është marrë edhe ndër studime të veçanta, të shënuara më sipër prej nesh. Kështu që teksti është fryt i një pune shumëvjeçare, duke përfshirë këtu edhe punën në auditor. Nga pikëpamja metodologjike, vepra paraqitet e mrë. Ajo mbështetet në

metodën historiko-krahasimtare. Në vështrimin e shumë ndryshimeve të planit morfologjik dhe morfonologjik, veprimi rrafshues i analogjisë, e cila në riorganizimin e sistemeve gjuhësore ka një rol të madh, është parë drejt. Vepra mbështetet në një analizë shkencore objektive dhe përshkrohet nga një frymë e shëndoshë kritike. I nisur nga mendimi i drejtë se studimi diakronik nuk mund të ndahet me mur nga studimi sinkronik, autori dukuritë historike nuk i ka parë të shkëputura nga sistemi i sotëm dhe nga prirjet e sotme. Gjuha e tekstit është e rrjedhshme dhe e kuptueshme. Stili nuk është as shumë i kursyer, as shumë i zgjatur.

Një veçori shumë pozitive e veprës është studimi i zhvillimeve të brendshme të shqipes. Duket se pikërisht, këto zhvillime kanë qenë edhe preokupacionet kryesore të autorit. Kjo vërehet në mbarë tekstin. Një tjetër veçori e mirë e librit është edhe krahasimi me gjuhët e tjera indoevropiane për disa fenomene gjuhësore, si p.sh. me indishten e vjetër, greqishten e vjetër, keltishten, armenishten, lituanishten, latinishten, gjermanishten, frëngjishten, rumanishten, greqishten e re, bullgarishten, maqedonishten.

Autori ka shfrytëzuar, me kujdes dhe në masën e duhur veprat e shkrimtarëve tanë të vjetër, si Buzuku, Bardhi, Bogdani etj., veprat e shkrimtarëve arbëreshë të Italisë dhe të Greqisë, folklorin shqip, materiale gjuhësore të diasporës, të dhëna nga të folmet e ndryshme të shqipes. Dhe, të gjitha këto, me përpikërinë dhe skrupolozitetin e duhur shkencor. Teksti, megjithëse shkencor dhe i një disipline të vështirë, siç është morfologjia historike, është i kapshëm për studentët. Kjo o detyrohet qartësisë së paraqitjes, metodikës së brendshme, anës didaktike, përvojës së gjatë të autorit si mësimdhënës në shkollën e lartë, kulutrës së tij filologjike, horizontit dhe diapazonit të tij të gjerë lingvistik.

Vepra *Morfologjia historike e gjuhës shqipe* (pjesa e I dhe II) është botuar në një vëllim të përbashkët (unik) nga Universiteti i Prishtinës në vitin 1975, me 403 faqe, tirazhi: 2000 kopje.

12. Vepra e prof. Shaban Deimrajt, *Sistemi i lakimit në gjuhën shqipe*, botuar nga Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë, Tiranë, 1975, me 275 faqe, është vazhdimi më i thelluar i disa problemeve të trajtuara edhe më parë nga autori ynë. Me gjithë kontributet e rëndësishme, që kanë dhënë studiues të ndryshëm, shqiptarë e të huaj, për sqarimin historik të sistemit lakimor të shqipes, mjaft çështje të këtij sistemi ose nuk janë trajtuar shterrueshëm, përkatësisht bindshëm, ose nuk janë prekur fare. Në këto rrethna, duke pasur parasysh edhe interesin e veçantë, që po tregohet kohët e fundit, për këtë temë sa të rëndësishme aq edhe të vështirë, autorit iu duk e arsyeshme të ndalet pak më gjatë në disa çështje të diskutueshme të sistemit lakimor të shqipes, të cilat në tekstin *Morfologjia historike e gjuhës shqipe*,

I(1973), për vetë destinacionin e atij libri, në përgjithësi ose janë trajtuar përmbledhtas, ose vetëm janë prekur.

Çështjet e trajtuara janë ndarë në shtatë kapituj, të cilët janë renditur në mënyrë të tillë që të plotësojnë njëri-tjetrin dhe të japin një ide sa më të qartë e sa më të plotë për evolucionin gradual, që ka pësuar sistemi lakimor i shqipes gjatë shekujve. Për të mos i ngarkuar pa nevojë kapitujt, janë lënë fare jashtë vështrimit disa çështje, që tashmë kanë gjetur zgjidhje të kënaqshme. Qëllimi i këtij vëllimi, pra, është të shtrojë një diskutim dhe të shpjegjë, sadopak, përpara zgjidhjen e atyre çështjeve të diskutueshme, që kanë të bëjnë me evolucionin historik të sistemit lakimor të shqipes, duke vënë në dukje edhe ç'është e trashëguar nga faza më e lashtë indoevropiane dhe ç'është krijuar brenda shqipes gjatë shekujve.

Janë bërë përpjekje që çështjet e veçanta, sa herë që ka qenë e mundur, të vështrohen brenda tërë sistemit lakimor, duke vënë në dukje ç'ka të përbashkët dhe ç'ka të veçantë në lakimin e emrave, të mbiemrave dhe të përemrave. Në trajtimin e këtyre çështjeve, autori është mbështetur, kryesisht, në krahasimin historik të brendshëm. Një rëndësi e veçantë i është dhënë, sidomos, rendit të fjalëve në fjali, çështje kjo, së cilës i duhet kushtuar edhe më shumë vëmendje në studimin historik të gramatikës së gjuhës shqipe (dhe jo vetëm të kësaj gjuhë).

Sa herë ka qenë e nevojshme, janë bërë përpjekje për t'i vështruar dukuritë gjuhësore të shqipes edhe në përqasje me dukuritë e ngjashme të gjuhëve të tjera, sidomos të gjuhëve ballkanike. Në mjaft raste, janë bërë përpjekje, gjithashtu, për t'i vështruar çështjet e shqyrtuara edhe nga pozitat e gjuhësisë së përgjithshme. Duke qenë se një numër gjithnjë e më i madh studiuesish të huaj, sidomos ballkanistë, po tregojnë një interesim të veçantë për dukuritë gjuhësore të shqipes, autori e ka parë të udhës që të shtojë në fund të këtij vëllimi dhe përmbledhje, pak a shumë të gjera, në gjuhën frënge për të shtatë kapitujt. Vëllimi është recenzuar në Katedrën e gjuhës shqipe të Fakultetit të Historisë e të Filologjisë të Universitetit të Tiranës nga Mahir Domi, Anastas Dodi dhe Remzi Përnaska. Në shtypin shkencor janë botuar recensione të favorshme nga Jup Kastrati, Fatmir Agalliu dhe Haralambie Mihaescu.

Gjuhëtari rumun, Mihaescu, ndër të tjera, thekson: Tre kapitujt e parë të kësaj vepre trajtojnë sistemin e lakimit të emrave e të përemrave, duke interesuar, në radhë të parë, fushën gjuhësore indoevropiane dhe duke përbërë po aq kapituj morfologjie historike. Përsa u takon katër kapitujve të fundit, aty trajtohen përemrat vetorë të patheksuar, nyja, dysia strukturore e mbiemrit në shqipe dhe rendi i përcaktorit emëror, me shembuj të shpeshtë të marrë nga gjuhët e Evropës Juglindore dhe me një kontribut të dobishëm për sintaksën historike. E tërë vepra ka si bosht diskutimin e nyjes, diskutim që paraqitet me

interes të veçantë edhe për historinë e gjuhës rumune. Duhet shënuar se autori i kushton rumanishtes një vëmendje më të theksuar se çdo gjuhë tjetër të këtij rajoni. Bibliografia e paraqitur nga autori pasqyron sidomos katër fusha dhe pikërisht: gjuhësinë e përgjithshme, gjuhësinë indoevropiane, albanologjinë dhe gjuhën rumune. Përmbajtja e veprës e justifikon interesin e saj për këtë gjuhën e fundit. Në favor të tezave të prof. Shaban Demirajt, Haralambie Mihaescu ka sjellë edhe konsideratata e romanistëve të mirënjohu për një shquese: G.Rohlf, Iorgu Iordan, Alexander Grauer dhe Sextil Puscarin.

13. Kryevepra e Akademikut Shaban Demiraj, *Gramatikë historike e gjuhës shqipe* u botua më 1986 nga Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë i Universitetit të Tiranës, në një vëllim voluminoz prej 1168 faqesh, në një përmbledhje të gjerë në anglisht prej 117 faqesh. Vepra u recenzua në Katedrën e gjuhës shqipe nga Ethem Likaj, Seit Manasku dhe Rahmi Memushaj. Botimi i këtij libri u përshëndet me entuziazëm në qarqet shkencore të vendit tonë, si një nga veprat madhore të shkencës së gjuhësisë shqiptare. Monografia qëndron me dinjitet në nivelet më të larta të arritjeve të studimeve albanistike në vendin tonë. Ndër të tjera, ajo vërteton vazhdimësinë e shqiptarëve në trojet e tyre të sotme. Me këtë botim, prof. Shaban Demiraj u afirmua, njëherë e përgjithmonë, si një nga personalitetit më të shquara të gjuhësisë shqiptare. Ai u imponua si një autoritet shkencor i padiskutueshëm në fushën e gramatikës historike të gjuhës shqipe.

Pas traktatit të njohur të F.Bopp-it, që është si të thuash, edhe sprovë e parë e një morfologjie historike të shqipes., problemet e strukturës gramatikore të kësaj gjuhë në evolucionin e saj historik kanë tërhequr vëmendjen e një vargu gjuhëtarësh, të huaj dhe shqiptarë, si: Gustav Mayer, Holger Pedersen, Wilhelm Meyer-Lubke, Norbert Jokl, Gustav Weigand, Aleksandër Xhuvani, Eqrem Qabej, Selman Riza, Martin Camaj, Namik Ressuli, Besim Bokshi, Marcello Durante, Seit Mansaku, Ethem Likaj, Rexhep Ismajli, Emil Lafe, Ndre Mjeda, Carcl Tagliavini, Vittore Pisani, Kolec Topalli, etj.

Krahas trajtimit të çështjeve të veçanta, të cilat në mjaft raste janë vështruar edhe në përjasje me gjuhë të tjera, ballkanike dhe joballkanike, janë bërë përpjekje edhe për të hartuar vepra sintetizuese, siç janë ndër të tjera: *Saggio di gramtologia comparata sulla lingua albanese* e Dhimitër Kamardës; *Studi Linguistici albanesi* (vëllimi I, II) të Marco La Pianës; *Morfologjia historike e shqipes* e Kostaq Cipos; *Morfologjia historike e shqipes* e Mahir Domit; *Historia e gjuhës shqipe (Morfologjia historike)* e Idriz Ajetit; *Morfologjia historike e gjuhës shqipe* (vëllimi I, II) e Shaban Demirajt; *An Albanian Historical Grammar* e Stuart E.Mann. Në këto vepra sintetizuese janë pasqyruar jo vetëm ndihmesat e gjuhëtarëve të ndryshëm, por edhe ato të vetë autorëve përkatës.

Puna e bërë deri sot ka bërë të mundur të hidhet dritë mbi një numër të konsiderueshëm çështjesh të morfologjisë dhe të sintaksës historike të shqipes. Por, natyrisht, mbetet për t'u bërë një punë edhe më e madhe për të ndriçuar një varg çështjesh të diskutueshme të gramatikës historike të kësaj gjuhe. Për sqarimin e këtyre çështjeve, sa të vështira aq edhe të rëndësishme, po bëhen përpjekje serioze nga gjuhëtarët shqiptar të Republikës së Shqipërisë dhe të Republikës së Kosovës, ashtu edhe nga albanologë të huaj. E, në vazhdim të këtyre projekteve, prof. Shaban Demiraj, disa vjetë më parë i hyri punës për të hartuar një tjetër vepër sintetizuese mbi evolucionin e strukturës gramatikore të gjuhës shqipe. Kjo vepër, *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*, synon të jetë jo vetëm sintezë e arritjeve të deritashme në këtë fushë studimesh, por edhe një përpjekje e mëtejshme për t'i çuar ato sadopak më përpara.

Në parathënie, autori thekson se, qysh në fillim, ishte i vetëdijshëm për vështirësitë e mëdha, që paraqiste hartimi i një vepre të tillë me përmasa të gjera. E kjo vetëdijshmëri iu bë gjithnjë më e qartë në punë e sipër, gjatë hartimit të veprës. Megjithatë, dëshira për të depërtuar sa më thellë në mjegullën e dendur, që mbulon ende rrugën e evolucionit historik të strukturës gramatikore të gjuhës shqipe, që një shtysë e fortë për të vazhduar pa u stepur, punën e nisur. Por kuptohet vetiu se në gjendjen e tashme të studimeve nuk mund të mëtohet për të sqaruar gjithçka. Prandaj edhe në këtë vepër, në disa raste, çështjet sa janë shtruar për diskutim, ndërsa në disa raste të tjera zgjidhjet nuk janë dhënë të prera.

Duke qenë se evolucionin e strukturës gramatikore të një gjuhë nuk është baraz me shumën aritmetike të ndryshimeve, që kanë pësuar pjesët e saj përbërëse, autori është përpjekur që faktet dhe dukuritë gjuhësore t'i shqyrtojë në lidhjet e tyre të ndërsjella si pjesë përbërëse të një sistemi tërësor, sado që ato, për arsye metodike, janë trajtuar në kapituj të veçantë. Veç kësaj, duke pasur parasysh lidhjen e ndërsjellë midis nënsistemeve të gjuhës, evolucionin e strukturës gramatikore të shqipes është vështruar në lidhje të ngushtë dhe me evolucionin e nënsistemeve të tjera të kësaj gjuhe, sidomos me atë të fonetikës, natyrisht në ato përmasa që lejonin arritjet e derisotshme në këtë fushë studimesh.

Janë bërë përpjekje, gjithashtu nga autori, që dukuritë gjuhësore të shqipes, sa herë ka qenë e nevojshme, të vështrohen edhe në përqasje me dukuritë e ngjashme të gjuhëve të tjera, sidomos të atyre gjuhëve të tjera, sidomos të atyre gjuhëve me të cilat gjuha jonë ka bashkëpërkime dhe paralelizma, siç janë rumanishtja, greqishtja, maqedonishtja, bullgarishtja etj. Në shpjegimin e fakteve dhe të dukurive të shqyrtuara janë marrë në vështrim edhe faktorët jashtëgjuhësorë, kur roli i tyre ishte i dukshëm. Por, natyrisht, në radhë të parë janë marrë në vështrim faktorët brendagjuhësorë, që kanë kushtëzuar evolucionin historik të strukturës gramatikore të gjuhës shqipe,

duke e bërë këtë sa më të zhdërvjelltë e sa më të përshtatshme për të plotësuar kërkesat e bartësve të kësaj gjuhe, gjithnjë në rritje nga një stad zhvillimi në tjetrin.

Në veprën *Gramatikë historike e gjuhës shqipe* një vend të gjerë kanë zënë çështjet e morfologjisë historike. Kjo është e shpjgueshme me vetë zhvillimin që ka pasur kjo fushë studimesh. Një vemendje e veçantë u është kushtuar edhe disa çështjeve të rëndësishme të sintaksës historike të gjuhës shqipe, por në këtë fushë mbetet ende shumë për të bërë. Në një kapitull më vete janë shqyrtuar dukuritë morfologjike të shqipes, ndërsa në *Hyrje*, midis të tjerave, janë trajtuar edhe çështje që kanë të bëjnë me fonetikën historike të shqipes si edhe me marrëdhëniet e kësaj gjuhe me gjuhët e tjera.

Gramatika historike e gjuhës shqipe e prof. Shaban Demirajt është ribotuar në Kosovë, Rilindja, Prishtinë, 1988, në 2.000 kopje tirazh. Në shtypin shkencor ka pasur disa recensione të favorshme nga Xhevat Lloshi, Rahmi Memushaj, Seit Mansaku. Autori, Sh. Demiraj, ka arritur të hedhë dritë të re për shumë e shumë çështje të veçanta, të cilat te mjaft studiues të tjerë ndiqeshin si fije të kuptuara ose të pështjelluara. Libri, në përgjithësi, është shkruar me një gjuhë të qartë e të përpiktë, lënda është sistemuar dhe ndarë në mënyrë që lejon të gjendet menjëherë çështja përkatëse dhe shtjellimi është i rrjedhshëm e kapet nga çdo lexues. Vështrimi i disa çështjeve në lidhjet e tyre të ndërsjella ka bërë që prof. Demiraj të ecë me hap të sigurtë edhe në fushën e etimologjisë, duke dhënë më se një ndihmesë origjinale. Nuk do të ishte e tepërt që nga libri të nxirreshin, si një fjalorth, të gjitha fjalët e shqyrtuara dhe shpjegimet etimologjike të arritura për to. Këtu jemi në vazhden e traditës më të mirë të etimologjisë shqiptare, që pati një përfaqësues të shquar si prof. Eqrem Çabej, i cili ndikon deri edhe me stilin e shprehjes. Në faqet e veprës gjejmë vëzhgime të holla e të peshuara për rumanishten, greqishten dhe gjuhët sllave të Ballkanit, që përbëjnë një ndihmesë të konsiderueshme për ballkanistikën. Libri i Sh. Demirajt përbën një ndihmesë të drejtpërdrejtë edhe për historinë e shqipes letrare, e cila mbetet si një detyrë për t'u plotësuar nga studimet tona. *Gramatikë historike e gjuhës shqipe* është një traktat i gjerë, sepse ngërthen disa trajtime së bashku. Përveç gramatikës historike në kuptimin e ngushtë të fjalës, aty kemi një diskutim të përimituar për të gjitha mendimet e shfaqura nga studiuesit e mëparshëm, duke mbajtur qëndrim kritik. Shumë teza të gjuhëtarëve e të albanologëve me autoritet kanë rënë ose janë rishikuar në dritën e kësaj sinteze të re. Nga ana tjetër, autori i tregon me përpikësi çështjet që mbeten të hapura për hulumtime të mëtejshme. Ky është një shembull se si një metodë e shëndoshë shkencore, e mbështetur në fakte të gjithanshme, jo vetëm është e frytshme me përfundimet që arrin, por është e frytëshme edhe me shtigjet që çel për të ecur më përpara. (Xh. Lloshi)

Gramatikë historike e gjuhës shqipe- shkruan Rahmi Memushaj- është një monografi e gjerë sintetizuese për evolucionin e strukturës gramatike të gjuhës shqipe. Është sintezë e përpjekjeve 130-vjeçare të gjuhëtarëve shqiptarë e të huaj dhe e përvojës së gjatë të autorit në këtë lëmë. Shënon një thellim të mëtjshëm në studimin e gramatikës historike të shqipes. Kjo vepër me përmasa të mëdha dallon nga veprat e llojit të vet të botuara gjetkë jo vetëm nga objekti i veçantë e detyrat që shtron për zgjidhje, por, në radhë të parë, nga parimet metodologjike, në të cilat mbështetet. Në të problemet dhe dukuritë janë parë duke u mbështetur në parimet e shkollës së re gjuhësore shqiptare. Kështu, evolucionin e strukturës gramatike të gjuhës nuk shihet vetëm si rrjedhojë e veprimit të faktorëve brendagjuhësorë. Sistemi i gjuhës merret në lidhjet e tij të ngushta me shoqërinë që e përdor, pra, në lidhje me faktorët e jashtëm që veprojnë mbi të. Këto parime autori i pohon dhe i zbaton gjatë punimit të tij.

Vepra ka një nivel të lartë shkencor. Në shtjellimin e materialit ka koherencë logjike, që bashkë me gjuhën e rrjedhshme, e bëjnë të lehtë e tërheqës leximi, megjithëse jemi në një fushë të vështirë. Libri përshkohet prej fillimit në fund nga polemika shkencore. Autorit të saj i është dashur të qortojë teza e hipoteza të paargumentuara mirë, madje të ndeshet edhe me teza, të cilat i mohojnë origjinalitetin gjuhës shqipe dhe popullit që e flet dhe e paraqesin shqipen si një gjuhë të përzier a dialekt të romanizuar dhe risitë në evolucionin e saj jo në radhë të parë si zhvillime të brendshme, por vetëm si rrjedhojë ndikimesh herë të latinishtes, herë të gegërishtes, herë të gjuhëve sllave, etj. Në këtë polemikë autori ka mbajtur një qëndrim shkencor parimor. Me objektivitet dhe maturi, ai polemizon me gjuhëtarët që mbrojnë këto teza, duke u përpjekur të provojë bindshëm pse kjo ose ajo tezë është e pambështetur a e gabuar. Në mjaft raste të tjera, duke iu përmbajtur së vërtetës shkencore, ai nuk nxitehet të pranojë pa i argumentuar thellë as ato teza, të cilat, dukuri të gjuhëve fqinjë të Ballkanit, i shpjegojnë përmes ndikimit të shqipes mbi to.

Megjithëse me karakter historik, vepra përshkohet tejndanë nga ideja e sistemit. Diakronia konceptohet prej autorit si kalim nga një rrafsh në një tjetër, pra, si një tërësi prejesh sinkronike dhe jo si studim i dukurive të veçuara, me lidhje historike, vertikale, por pa lidhje me dukuritë e tjera të të njëjtit rrafsh sinkronik. Çdo dukuri që analizohet në të, merret në lidhjet e saj të ndërsjella me dukuritë e të njëjtit rrafsh. Si rrjedhim, edhe supozimet e bëra, edhe pohimet rreth një dukurie të caktuar të një prerjeje sinkronike të dhënë nuk bien në kundërshtim me pohimet e mëparshme a të mëvonshme për të, trajtat e rindërtuara zënë vend mirë në sistem. Vepra ka edhe momente përshkruese. Por, sado që trajtimet sinkronike zënë një vend jo të vogël, na duket se ato janë në funksion të shpjegimit historik të dukurive e rrjedhimisht,

të kapërthyera mirë me pohimet historike dhe formojnë kështu një të tërë të lidhur, nga e cila nuk mund të heqësh gjë pa e cunguar.

Karakteri diakronik të monografisë vjen e i shtohet edhe plani krahasues. Gjatë trajtimit të dukurive të ndryshme, krahas historisë së brendshme, sidomos në ato raste kur kjo është e pamjaftueshme për t'i shpjeguar si duhet këto dukuri, autori i drejtohet edhe krahasimit të jashtëm, duke i përqasur dukuritë e shqipes me dukuritë paralele në gjuhët e tjera indoevropiane. Kjo gjë ia rrit edhe më shumë vlerat, pasi bëhen më të mbështetura zgjidhjet e dhëna. Në këtë monografi, rrethi i gjuhëve që merren për krahasim, është zgjeruar mjaft, nga gjuhët skandinave në veri, deri te gjuhët e Ballkanit në jug, nga portugalishtja në perëndim e deri tek armenishtja, iranishtje e sanskritishtja në lindje. Nëpërmjet përqasjes tregohen përbashkësitë e shqipes herë me një grup e herë me një grup tjetër gjuhësh dhe rastet kur ajo ndjek një rrugë të veçantë në evolucionin e saj. Në këtë mënyrë, autori sjell një ndihmesë jo të vogël edhe për vetë gjuhësinë e krahasuar e për indoevropianistikën në përgjithësi. Një vend të veçantë kanë zënë në vepër marrëdhëniet e shqipes me gjuhët e tjera të Ballkanit. Ai e pranon lidhjen gjuhësoore ballkanike, veçse qëndrimi i tij edhe në këtë pikë është shumë i matur e objektiv. I pranon dukuritë e substratit dhe të adstratit, por ndryshe nga shumë gjuhëtarë ballkanas e evropianë mjaft nga dukuritë e ngjashme në gjuhët ballkanike i sheh si zhvillime të brendshme paralele.

Paraqitja e gjendjes në studimet për gramatikën historike të shqipes i ka shërbyer autorit si një pikënisje për të parashtruar qëndrimin e vet për dukuritë në shqyrtim. Duke pranuar arritjet e zgjidhjet që i kanë qëndruar kohës, ai hedh një varg tezash e hipotezash të reja për një numër problemesh ende të pazgjidhura, rimerr teza të mëparshme të tij e sjell material të ri e argumentime të reja në mbështetje ose kundër tyre. Me gjithë ndihmesat e shumta që sjell, autori, në mjaft raste, e lë problemin të hapur ose ngre probleme të tjera, duke çelur në këtë mënyrë horizonte të reja për historianët e gjuhës shqipe e duke treguar edhe rrugët që duhet të ndjekë gjuhësia jonë historike për zgjidhjen e çështjeve të mbetura pezull.

Monografia *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*, duke ndriçuar evolucionin e gjuhës sonë, ndihmon edhe për zgjidhjen e problemeve të gjenezës e të formimit të kombit shqiptar dhe të gjuhës së tij. Veç kësaj, ajo do të shërbejë si një manual i pazëvendësueshëm për brezat e rinj të historianëve të gjuhës shqipe dhe për këdo që do të dijë diçka për gramatikën historike të shqipes. Botimi i kësaj vepre e rrit edhe më tepër prestigjin e gjuhësisë sonë në opinionin e brendshëm e të jashtëm shkencor.

Me të drejtë shënon Seit Mansaku, se vepra *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*, duke i trajtuar kategoritë gramatikore në një shtrirje të gjerë kohore dhe nga shumë aspekte, ka vlera të mëdha edhe për gramatikën e

sotme, jo vetëm në kuptimin që sqarimi i evolucionit historik të një gjuhe ndihmon edhe për të kuptuar dhe shpjeguar më mirë strukturën e sotme gramatikore të saj, për të përcaktuar ligjësitë dhe prirjet e zhvillimit të sotëm e të mëtejshëm të saj, por edhe në kuptimin më të drejtëpërdrejtë: në këtë vepër historike ka përkufizime, përcaktime e vërejtje për vlerën gramatikore dhe funksionet sintaksore të shumë trajtave të sistemit gramatikor të shqipes së sotme.

Së fundi, vepra paraqet interes edhe për gjuhësinë ballkanike dhe indoevropiane. Studimi i thelluar në rrafshin diakronik i strukturës gramatikore të shqipes si një gjuhë që përfaqëson një degë më vete në familjen e gjuhëve indoevropiane edhe me një rol të veçantë në lidhjen gjuhësore ballkanike, përbën pa dyshim edhe një kontribut, edhe një mbështetje për gjuhësinë indoevropiane dhe gjuhësinë ballkanike. Përdorimit të kësaj vepre edhe për stduime në këto fusha dhe njohjes së saj nga albanologë dhe studiues të tjerë të huaj i shërben edhe përmbledhja mjaft e plotë prej më se 100 faqesh në anglishte, me të cilën është pajisur kjo vepër.

Parashtrimi i qartë e sistematik i lëndës, me gjithë vështirësit që paraqet shtjellimi dhe përpunimi i saj, përkufizimet e sakta, por të formuluar thjesht, e bëjnë këtë vepër të kapshme dhe të përdorshme jo vetëm nga specialistët e ngushtë, por edhe nga punonjës të tjerë të shkencës, të arsimit dhe të kulturës. Përdorimin e veprës e lehtëson mjaft edhe pasqyra analitike e lëndës prej 20 faqesh, që paraqitet në vetvete si një indeks i çështjeve që trajtohen në të. Vepra shquhet edhe për një ekzemplifikim të zgjedhur dhe të larmishëm. Shumë herë jepen lista shterruese që përfshijnë pothuajse të gjitha rastet që i nënshtrohen një rregulle ose një evolucionit historik të caktuar. Bie në sy, sidomos njohja e thelluar e teksteve të vjetra dhe e dialekteve të shqipes dhe shfrytëzimi racional i të dhënave të tyre. Vepra përbën një realizim dinjitoz për autorin dhe një sukses të gjuhësisë sonë historike.

Një punim i përmbledhur i *gramatikës historike të gjuhës shqipe* është botuar gjermanisht me 367 faqe, ndërsa botimi shqip i Tiranës ka 1168 faqe. Ja titulli: *Historische Grammatik der albanischen Sprache*. Botuar nga: Osterreichische Akademie der Wissenschaften-Philosophisch-historische Klasse. Schriften der Balkan Kommission. Philologische Abteilung, 34. Paraqitur nga anëtari i Akademisë Austriake në mbledhjen e 6 nëntorit 1991. - Verlag der Osterreichischen Akademi der Wissenschaften. Wien 1993. Faqe 367.

14. Specialiteti i Akademikut Shaban Demiraj është ai i historianit të gjuhës shqipe. Si i tillë, ndër të tjera, ai ka botuar një varg artikujsh shkencorë dhe studimesh. Po i shënoj këtu në rend kronologjik: *Rreth studimit të historisë së gjuhës shqipe* (1974), *Shqipja-gjuhë indoevropiane* (1983), *Shqipja-gjuhë ballkanike* (1983), *Rreth studimit për historinë e gjuhës*

shqipe (1983), *Rreth emrit të lashtë të popullit dhe të gjuhës sonë* (1984), *Risi karakteristike të gjuhës shqipe* (1987), *Formime karakteristike në sistemin foljor të gjuhës shqipe* (1989), *La lingua albanese* (1993), *L'albanese* (1994), *L'albanis* (1994), *Problemi i prejardhjes së gjuhës shqipe* (1996), etj.

Duke ndjekur gjurmët e dijetarëve të shquar Bopp, Kamarda, Meyer, Pedersen, Jokl, Xhuvani, La Piana, Çabej, Domi, Riza, etj., Shaban Demiraj, më 1988, botoi librin: *Gjuha shqipe dhe historia e saj*. Univeristeti i Tiranës. Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë. Shtëpia Botuese e Librit Universitar, 322 faqe. Tirazhi 5000 kopje. Kjo vepër u ribotua edhe në Kosovë, Rilindja, Prishtinë, 1989. Tirazhi: 3000 kopje. Është duke u botuar italisht edhe nga Universiteti i Kalabrisë, Kozencë. Duhet të dalë së shpejti.

Teksti synon t'u përgjigjet kërkesave të atyre që duan të kenë në dorë një vepër sintetizuese për gjuhën shqipe dhe për historinë saj. Në pamundësi që të trajtohen gjerësisht të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me sistemin e gjuhës shqipe dhe me evolucionin e saj historik, këtu janë dhënë kryesisht njohuri të përmbledhuara mbi disa çështje themelore. Pas një hyrjeje, në kapituj të posaçëm trajtohen këto çështje: Shqipja-gjuhë indoevropiane. Vendi ishqipes në rrethin e gjuhëve indoevropiane, Shqipja-gjuhë ballkanike. Disa tipare të veçanta të gjuhës shqipe, Shqipja gjuhë sintetike-analitike, Shtresimi kohësor i fjalorit të gjuhës shqipe, Fondi i trashëguar i fjalorit të shqipes. Elementetet e huaja që shqipja i ka trashëguar nga "nëna" e saj., Huazimet e vetë shqipes. Përpjesëtimi i elementit të huaj ndaj elementit vendës. Prejardhja e gjuhës shqipe. Vendi dhe koha e formimit të gjuhës shqipe. Rreth periodizimit të historisë së gjuhës shqipe. Emërtimi i gjuhës shqipe ndër shekuj. Ndarja dialektore e gjuhës shqipe. Lëvrimi i gjuhës shqipe. Një përmbledhje e librit është dhënë në gjuhën angleze me 30 faqe. Vepra u recenzua nga Ethem Likaj, Seit Mansaku. Libri ka një bibliografi të hapët, të gjerë, me 333 tituj studimesh së ndryshme.

Është një vepër sintetizuese, që plotëson më tej fondin e studimeve të plota historike për gjuhën shqipe. Ka çështje të njohura, -thekson Ethem Likaj-por të thelluara më tej, ka edhe çështje të tjera më pak të njohura a të panjohuara me zgjidhje të plotësuara, të reja. këto çështje janë trajtuar së bashku që të shfrytëzohen jo vetëm nga specialistët, por edhe nga një rreth më i gjerë lexuesish. Vepra nga ndërtimi dhe shtjellimi ndryshon nga tekstet mësimore edhe nga monografite e mirëfillta shkencore. Është një vepër e veçantë, ku çështjet e zgjidhjet shkencore plotësojnë kufirin historik të zhvillimit të gjuhës shqipe. Disa krerë edhe veçmas zgjerojnë e plotësojnë kulturën gjuhësore për një masë të gjerë specialistësh. Në këtë punim lexuesi gjen edhe shumë referime për të marrë njohuri më të plota për çështje të veçanta. Por edhe kur autori i thjeshton disa çështje, për t'i bërë sa më të

përvetësueshme, ato ruajnë vlerat e tyre shkencore. Çdo krye i librit del me një emërtim të veçantë, por çështjet që trajtohen aty, janë më të gjera. Në disa raste syresh, me plotësime e pak hulumtime të mëtejshme, mund të dilte edhe si punim në vete.

Një trajtim i hollësishëm i është bërë shtresëzimi kohor të fjalëve të përbashkëta të shqipes dhe të rumanishtes. Për herë të parë, mbi këtë bazë dhe mbi bazën e ndryshimeve foentike, nxirren përfundime të rëndësishme për burimin e tyre. Në shtresëzimet e greqizimave interpretime janë bërë në mbështetje të autoktonisë së shqiptarëve. Në analizën e përpjestimit të elementit anas ndaj atij të huaj vihen në dukje mendimet më të qëndrueshme, duke paraqitur edhe argumente që i mbështesin ato. Në këtë vepër, pra, lexuesi specialist, por edhe jospecialist, ka të sintetizuar mendimin e zgjedhur për burimin, karakterin dhe zhvillimin e gjuhës shqipe. Vepra është edhe një libër tjetër dijeje dhe kulture, që i shtohet letërsisë sonë gjuhësore dhe me plot vlera.

15. Kontribute të çmuara ka dhënë Shaban Demiraj për historinë e albanologjisë me një varg punimesh për dijetarët: Kopitar, Schleicher, Hahn, Bopp, Miklosich, Meyer, Weigend, Sandfeld, Seliscev, Mihaescu, etj. Në historinë e gjuhësisë shqiptare, pas artikujve për Sami Frashërin, Aleksandër Xhuvanin, Mahir Domin, Selman Rizën, padyshim libri i Demirajt: *Eqrem Çabej. Një jetë kushtuar shkencës*, Tiranë, 1990, është një vepër e vyer për lëvizjen mendore dhe studimet shqiptare. Libri për Çabejn, i shkruar me dije, qartësi dhe fisnikëri nga profesor Shaban Demiraj, - thotë Ismail Kadare- e kryen më së miri këtë rol. Në këtë libër, që është një akt kulturor e moral i admirueshëm, lexuesi ynë do të gjejë të përkthyer qartë tërë aksionin e dijetarit dhe njeriut të madh, ngjitjen e tij në lartësitë e vështira të shkencës, mundin, hulumtimet, përfytyrën, thellimin gjer në ditët e fundit të jetës në atë univers që është sa pasionant, aq dhe i tmerrshëm në ndërlikimin e tij: universin e gjuhëve. Profesor Demiraj, në mënyrën më të kuptueshme që mund të bëhet, na ka shpalosur planin e ngrehinës Çabejane, prmasat, spikamën e përgjithshme, lartësitë dhe kullat e saj. Lexuesi do të kuptojë nga ky libër përse kjo ngrehinë është e madhe dhe tejet e rëndësishme, një bastion i vërtetë i qytetërimit shqiptar.

Ky libër i Sh.Demirajt për jetën dhe veprën e Eqrem Çabejt është shenjë nderimi dhe vlerësimi për veprimtarin e shumanshme dhe ndihmesën e madhe në zhvillimin e kulturës shqiptare të këtij gjuhëtari të shquar. Ajo vjen në një kohë, kur vepra e Çabejt më shumë se kurrë është e domosdoshme të bëhet e njohur për masat e gjera të popullit tonë, për t'i shërbyer, me gjerësinë e problemeve të trajtuara, me nivelin e lartë shkencor, me thellësinë e qartësinë e argumentimit, me përpikërinë e stilit dhe elegancën e tij, çështjes së afirmimit të mëtejshëm të kombit shqiptar, të cilit ai i shërbeu me devocion

deri në fund të jetës së vet. Vepra, e shkruar me një stil të thjeshtë, përmban të dhëna kryesore të jetës e të veprimtarisë së E.Çabejt, si dhe ndihmesën që ka dhënë ai, në të gjitha fushat ku ka punuar.

Ky libër-shënon Menella Totoni-është i plotë në paraqitjen e fushave, të ideve dhe të arritjeve kryesore të veprës së Çabejt, megjithatë është e natyrshme që këtu nuk mund të zërthehen të gjithë artikujt e tij. Lexuesi i interesuar do ta plotësonte më tej njohjen e kësaj veprimtarie shkencore me leximin e vetë veprës së E.Çabejt. Por, ndërkaq, ai do të dëshironte të dinte më shumë për Eqrem Çabejnë njeri. Ndonëse jo e bujshme, jeta e tij është e mbushur edhe me ngjarje interesante për lexuesin. Karakteri i tij i përsosur, sjellja plot nderim me të gjithë ata që kishte të bënte dhe me ata që takonte rastësisht, qëndrimi i tij prej të barabarti me të gjithë kolegët, pa dallim moshe, gatishmërie për të ndihmuar e për të vlerësuar punën e kujtdo, pasioni i tij për punën dhe seriozitetin me të cilin kryente çdo detyrë, rregulli dhe organizimi i ditës së punës si shkencëtar dhe i jetës private donin një trajtim më të gjerë e më të plotë në këtë vepër. Dikush tjetër mund ta plotësojë edhe këtë anë të personalitetit të Eqrem Çabejt. Kjo do të ishte edhe dëshira e autorit të librit.

Libri *Eqrem Çabej* i prof.Shaban Demirajt i drejtohet një rrethi shumë të gjerë lexuesish, me dhe pa përgatitje të veçantë gjuhësore. Atje ata do të njohin jo vetëm jetën dhe veprimtarinë e këtij personaliteti, që do të mbetet model për t'u ndjekur nga brezat e rinj të shkencëtarëve tanë, por do të mësojnë edhe ç'vend zë kjo veprimtari në tërësinë e kulturës shqiptare. Ata do të njohin e do të përvetësojnë pa ndonjë mundim mendimet e Eqrem Çabejt për prejardhjen e gjuhës shqipe e për zhvillimin e saj në shekujt, që janë aq të nevojshme për një shqiptar të kulturuar.

Duke përfunduar një recension të vetin, Begzad Baliu, shprehte këtë mendim: "Niveli i lartë i përkushtimit, akribia e thellë shkencore, me qëllim të prezentimit të vlerave dhe kulmeve më të arritura të punës shkencore të Çabejt, këtë monografi të Demirajt e bëjnë shumë të çmueshme dhe, pa u mbështetur në rezultatet e saj, në të ardhmen nuk mund të paramendohen studimet mbi jetën dhe veprën e profesor Eqrem Çabejt".

16. Akademiku Shaban Demiraj ka kohë që ka hyrë në fondin e artë të kulturës kombëtare shqiptare. Por ai i ka kuptuar edhe kufijtë e sotëm shtetërorë. Me veprën e tij *Gjuhësi ballkanike* Shkup 1994, me 278 faqe, e botuar nga Shtëpia Botuese Logos-A në bashkëpunim me Katedrën e Gjuhës dhe Letërsisë shqiptare në Fakultetin Filologjik të Universitetit "Çirili e Metodi" të Shkupit, prof.Demiraj u afirmua edhe si një ballkanolog i shquar i ditëve tona. Libri është recenzuar nga Luan Starova, Seit Mansaku dhe Jorgji Gjiniari, me redaktor Remzi Nesimi.

Nën titullin: *Ballkanska lingvistika*, vepra e prof. Shaban Demirajt, *Gjuhësi ballkanike*, u përkthye prej shqipes në maqedonishte nga Dr. Haki Ymeri. Redaktor: Dr. Dimitar Pandev. Logos-A. Shkup, 1994.

Duke pasur parasysh zhvillimin e studimeve krahasuese mbi gjuhët ballkanike, sidomos pas botimit të veprës së Kristian Sandfeldit më 1930, autorit tonë të nderuar Demirajt, iu duk e arsyeshme të përgatisë për lexuesin shqiptar një vepër sintetizuese mbi gjuhësinë ballkanike, ku pasqyrohen edhe ndihmesat e gjuhëtarëve të ndryshëm në këtë fushë studimesh. Hartimi i një vepre të tillë ishte i nevojshëm edhe për të vënë në dukje, në mënyrë më të plotë se deri më sot, të dhënat e shqipes, që dëshmojnë për tiparet ballkanike të saj. Por hartimi i kësaj vepre paraqiste edhe vështirësi të shumta, që kishin të bënin me përzgjedhjen e lëndës, por edhe më shumë me shpjegimin e çështjeve në mënyrë sa më të argumentuar. Vepra ndihmon në zhvillimin e mëtejshëm të studimeve krahasues në fushën e ballkanistikës.

Monografia hapet me një hyrje dhe me historikun e studimeve përkatëse. Pastaj ndjekin: Gjendja gjuhësore e gadishullit Ballkanik në lashtësi. Gjendja e sotme gjuhësore në Gadishullin Ballkanik. Disa bashkëpërkthime në fushën e fonetikës. Bashkëpërkimi i rasave gjinore dhe dhanore. Prapavendosja e nyjës shquese. Format e kohës së ardhme. Rimarrja e kundrinave. Mënjanimi i paskajores. Disa bashkëpërkime të tjera midis gjuhëve ballkanike. Bashkëpërkime midis shqipes dhe rumanishtes. Disa bashkëpërkime në fushën e fjalorit në gjuhët ballkanike. Vepra mbyllet me aparatën e duhur shkencor dhe me një përmbledhje në gjuhën anglishte.

Rexhep Doçi ka botuar një recension të favorshëm. Recensionin hapet me këto fjalë: "Vepra më e re e profesor Shaban Demirajt, *Gjuhësi ballkanike*, që është përkthyer dhe në maqedonishte, përmban vërtetime e analiza të reja me vlerë të pakrahasueshme jo vetëm për gjuhësinë shqiptare, por përgjithësisht për gjuhët krahasimtare ballkanike dhe jashtëballkanike". Recensionin mbyllet me këtë karakterizim përgjithësues: "Vepra e Akademikut Shaban Demiraj, *Gjuhësi ballkanike*, është një enciklopedi për studimet krahasimtare të gjuhëve ballkanike në përgjithësi, e për lexuesit shqiptarë në veçanti".

17. Në përmbyllje të kësaj ekspozite të veprimtarisë shkencore të Akademikut Shaban Demiraj, zhvilluar prej tij për një gjysmë shekulli, dëshirojmë të përmend këtu vëllimin e porsadalë nga shtypi: *Gramatika e gjuhës shqipe*. I. Tiranë, 1995, me 452 faqe, hartuar nga Fatmir Agalliu, Engjëll Angoni, Ali Dhrimo, Emil Lafe, Ethem Likaj, ku Shaban Demiraj është redaktori i vëllimit të parë, *Morfologjia*, ndërsa kryeredaktor është Mahir Domi. Libri është një variant i përpunuar i botimeve të mëparshme të viteve 1971, 1976, 1983. Në këtë vepër përshkruhet dhe shpjegohet struktura gramatikore e shqipes së sotme, kryesisht e periudhës pas formimit të shtetit të pavarur shqiptar. Ajo mbështetet në një lëndë gjuhësore të vjelë posaçërisht

nga letërsia artistike, shkencore dhe nga publicistika e kësaj periudhe. Vepra ka karakter normativ. Ajo synon të japë një përshkrim sa më të plotë të strukturës gramatikore të shqipes së sotme dhe të trajtojë teorikisht nocionet gramatikore përkatëse. Si e tillë, ajo shërben edhe si tekst mësimor i gramatikës së gjuhës shqipe për shkollat e larta. Vëllimi i parë i kësaj vepre përfshin morfologjinë, në kuptimin e gjerë të fjalës. Në të jepet përshkrimi i kategorive gramatikore të shqipes, i kuptimeve dhe i mjeteve të shprehjes së tyre dhe i përdorimeve e funksioneve të pjesëve të ndryshme të ligjëratës. Krahas kësaj, i është kushtuar vëmendje edhe paraqitjes së sistemit fjalëformues të shqipes së sotme.

Në fushën e gramatologjisë shqiptare janë për t'u përmendur këtu edhe dy vëllimet: *Çështje të fonetikës dhe gramatikës së sotme*, volumi I, Tiranë, 1972, me 335 faqe, botim i Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë, Sektori i gramatikës, me redaksi: Mahir Domi (përgjegjës), Shaban Demiraj, Jorgji Gjinari dhe Seit Mansaku. Demiraj, përveç si anëtar i redaksisë, ka përfshirë në të edhe tri studime të botuara më përpara në shtypin tonë shkencor.

Vëllimi i dytë: *Çështje të gramatikës së shqipes së sotme*, botim i Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë, Sektori i Gramatikës, Tiranë, 1975, me 263 faqe, me redaksi të përbërë nga: Mahir Domi (përgjegjës), Shaban Demiraj dhe Enver Hysa.

Në qoftë se kujtojmë këtu edhe recensionet e Shaban Demirajt për veprat e Besim Bokshit, Georg Renatus Solta, Ethem Likajt etj., dhe bashkëpunimin e tij në *Fjalorin Enciklopedik Shqiptar*, Tiranë, 1985, më duket se kam parashtruar gjithë veprimtarin e tij shkencore. Po të më ketë rrëshqitur ndonjë botim i tij sado i vogël qoftë, i kërkojë ndjesë autorit të nderuar.

18. Duke e rrokur me një vështrim përmbledhës gjithë sa u tha më sipër, mund të thom se Akademiku Shaban Demiraj, në jubileun e tij të 75 vjetorit të lindjes, del me një bilanc shumë të pasur botimesh nga fusha e leksikologjisë, fonetikës, morfologjisë, sintaksës, gramatikës historike, historisë së gjuhës shqipe, etimologjisë, gjuhës së shkruar shqipe, gjuhës letrare, ortografisë, ballkanistikës, marrëdhënieve gjuhësore shqiptaro-rumune, historisë së albanologjisë, si edhe redaktimeve gjuhësore, përshtatjeve në gjuhën e stome nga e folmja e arbëreshëve të Italisë, përkthimeve artistike nga anglishtja dhe publicistikës.

Akademiku Shaban Demiraj, sot për sot, është në kulmin e aktivitetit të tij krijues në fusha të ndryshme të dijes së gjuhësisë. Truri i tij nuk ka mplakje. Ai karakterizohet për serenitet mendor, për fuqi analize dhe sinteze, për forcë interpretuese, depërtuese, përgjithësues dhe konkluduese. Me profesor Shabanin më lidh një miqësi e çiltër pesdhjetëvjeçare, një bashkëpunim i ngushtë gjysmëshekullorë në fushën e studimeve albanologjike dhe në atë të shkollës së lartë. Kam nderin dhe kënaqësinë e veçantë t'i urojë

me zemër kolegu: Shëndet të plotë edhe për shumë vjet të tjera për të mirën e studimeve albanologjike dhe ballkanologjike?¹

Shënime biografike

Shaban Demiraj ka lindur në Vlorë, më 1 janar 1920. Shkollën plotore (filllore) e mbaroi në Vlorë. Shkollën e mesme (Medresenë e Përgjithshme) e kreu në Tiranë, më 1939. Shkollën e lartë e ka kryer me korrespondencë në dy etapa: Institutin Pedagogjik 2-vjeçar më 1948 dhe Institutin e Lartë Pedagogjik 4-vjeçar më 1954. Ka studiuar latinisht, greqishte të vjetër e të re, anglisht, frëngjisht, gjermanisht, rumanisht, gjuhët sllave të Ballkanit dhe pak Spanjisht Gjatë vjetëve 1948-1954 ka punuar si mësues i letërsisë shqipe në Gjimnazin e Gjirokastrës, në Politeknikumin e Tiranës dhe në Shkollën Pedagogjike të Tiranës. Para se të hynte në shërbim si arsimtar, ka punuar si përkthyes në Agjencinë Telegrafike të Shqipërisë. Nga vitit 1954 deri më 1990 ka punuar në shkollë të lartë (në ish-institutin e Lartë Pedagogjik dhe më pas në Universitetin e Tiranës) si pedagog i morfologjisë së gjuhës shqipe dhe qysh nga vitit 1972 ka dhënë gramatikën historike të gjuhës shqipe. Ka zhvilluar edhe kurse speciale për gjuhësinë ballkanike dhe për gjuhësinë indoevropiane, sidomos në kurset pas-universitare. Në vitin 1972 iu dha titulli Profesor. Më 1989 u bë anëtar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. Në vitin 1990 doli në pension. më 1993 u emërua kryetar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. Më 1994 është zgjedhur kryetar i Komitetit Kombëtar Shqiptar të A.I.E.S.E.E.-së dhe po atë vit u zgjodh edhe nën-president i A.I.E.S.E.E.-së. Më 1987 i është dhënë titulli "Mësues i Popullit". Më 1979 i është dhënë Çmimi i Republikës së klasit të dytë për veprën *Sistemi i lakimit në gjuhën shqipe* dhe më 1989 ka marrë Çmimin e Republikës të shkallës së parë për veprën *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*. Ka marrë pjesë në Kongreset I, IV, VI dhe VII të A.I.E.S.E.E.-së si dhe në disa konferenca dhe kollokuiume ndërkombëtare. Ka mbajtur ligjërata në universitetet e Prishtinës, Shkupit, Romës, Kopenhagës, Aarhus-it, Vjenës, Bonn-it, Kozencës, Palermos dhe Kluzhit.

¹ Referat i mbajtur më 1 mars 1996, në Fakultetin e Historisë dhe të Filologjisë, në Sesionin shkencor, organizuar nga Universiteti i Tiranës dhe Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, me temë: *prof. Shaban Demiraj-figurë e shquar e shkencës dhe e arsimit shqiptar*, me rastin e 75-vjetorit të lindjes. Variant i zgjeruar. (J.K)

